- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i

ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula**

**Shtojca 7**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

## **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

*b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*

*c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*

*ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

*d. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*

*dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:**

- Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 7)

#### **a. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

- Kopje të çertifikuar të bilanceve per dy vitet të fundit ushtrimor (2017,2018), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuar nga ky autoritet.

-Kopje të deklarimit të xhiros vjetore per tre vitet e fundit (2017,2018,2019), lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fondit limit.

-Vërtetim lëshuar nga institucionet përkatëse për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019.

## 2.2 Për kapacitetin teknik:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontrata të ngjashme shërbimesh në vlerë totale jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

### **Per te vertetuar përvorjen e meparshme detyrimisht të paraqiten dokumentat si me poshte:**

a. Kur kontratat janë të realizuara me institucione shtetërore ofertuesi duhet të paraqesë kontratën e lidhur me Institucionin të shoqëruar me vertetimet nga institucioni me të cilin janë nënshkruar këto kontrata mbi realizimin me sukses të tyre, ku të shënohet data, vlera, dhe shërbimet e realizuara.

b. Kur kontratat janë të realizuara me subjekte private ofertuesi duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes (ku të shprehen qartë datat, shumat, dhe shërbimet e realizuara, të firmosura dhe të vëlosura nga të dy palët).

## 2.3 Licensa profesionale e shoqërisë lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

### Punime të përgjithshme ndërtimi

NP - 1	Punime gërmimi në tokë
NP - 2	Ndërtime civile dhe industriale
NP - 4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha...
NP - 5	Punime nëntokësore...
NP - 7	Ujësjellës, kanalizime...
NP - 12	Punime të inxhinierisë së mjedisit...

### Punime speciale ndërtimi

NS - 4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to...
NS - 9	Punime strukturore speciale
NS - 18	Punime topogjeodezike

2.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë, drejtues teknik të kualifikuar si më poshtë:

- Drejtues Teknik Inxhinier Ndërtimi, 2 (dy),
- Drejtues Teknik Inxhinier Hidroteknik, 2 (dy),
- Drejtues Teknik Inxhinier Mekanik/Elektromekanik, 1 (një),
- Drejtues Teknik Inxhinier Elektrik, 1 (një),
- Drejtues Teknik Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder, 1 (një),

Drejtuës Teknik Inxhinier Gjeolog/Gjeoteknik, 1 (një),

Për stafin e drejtuesve teknik duhet të paraqitet kontrata individuale e punës (e vlefshme) e lidhur para noterit, Diplomë, CV, Licencë Profesionale personale për “Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi”.

**2.5** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) 1 (një) **Drejtuës teknik (njëri nga /Inxhinier Hidroteknik/ndërtimi)** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryen punime në objekt.

**2.6** Për efekt të kryerjes së shërbimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 14 (katërmbëdhjetë) punonjës të siguruar për periudhën Dhjetor 2019 - Maj 2020, dokumentuar me vërtetimin e lëshuar nga administrata tatimore. Gjithashtu ofertuesi duhet të paraqesë listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të plotësuara rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohen nga legjislacioni në fuqi për secilin muaj të periudhës së mësipërme.

Per kete kriter, operatori ekonomik duhet te paraqese :

1.Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj,

2. Listëpagesat përkatëse, shoqëruar me Formularin E–SIG 025/a dhe formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën **Dhjetor 2019 – Maj 2020**.

**2.7** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie (të vlefshme) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë)
- ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit Mjedisor)
- OHSAS 18001:2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) ose ISO 45001:2018
- PAS 99:2012 (Sistemi i Integruar i menaxhimit)
- ISO 39001:2012 (Për sigurinë në trafikun rrugor)

Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatat e mësipërme, sipas natyrës së shërbimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit

**2.8** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me

- GPS
- Total station,(ne pronesi ose me qera)

**2.9** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një analizë të çmimit mbi tarifën/at profesionale të ofruara, duke specifikuar saktë të gjithë elementet që ka marrë parasysh në llogaritjen e çmimit, si dhe duke plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, sipas grupeve tarifore dhe ndarjeve funksionale të parashikuara në këtë vkm.

Vlera e ofruar duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

***Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, do të skualifikohen.***

*(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.



**Shtojca 9**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>		
<b>02</b>		
<b>03</b>		
<b>...</b>		

**Shtojca 10**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet:

**“SHËRBIMI MBIKQYRJE PUNIMESH-SUPERVIZION I OBJEKTIT : NDERTIMI I UJESJELLESIT TE FSHATRAVE PLLANE, ZEJMEN, MARKATOMAJ, SPITEN, TRESH, NJ. AD. ZEJMEN, BASHKIA LEZHE ”**

Afatet e ekzekutimit: 18 Muaj nga lidhja e kontrates.

**Shtojca 11**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

## TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“SHERBIMI MBIKQYRJE PUNIMESH-SUPERVIZION I OBJEKTIT : NDERTIMI I UJESJELLESIT TE FSHATRAVE PLLANE, ZEJMEN, MARKATOMAJ, SPITEN, TRESH, NJ. AD. ZEJMEN, BASHKIA LEZHE”**

Detyrat: Mbikqyrja e punimeve.

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh, Nj. Ad. Zejmen, Bashkia Lezhe**

Afatet e ekzekutimit: **18 muaj**

Afati i realizimit të supervizionit të punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga sipërmarrësi i cili do të zbatojë punimet si dhe inspektimet gjatë periudhës së garancisë kur kërkohet nga investitori.

Në nenin 7 të ligjit Nr.8402, datë 10.9.1998 “Per Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndertimit”, të ndryshuar parashikohet se: *“Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit caktohet një punonjës i investitorit, gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse.”*

Në bazë të Udhezimit Nr.1, date 16.06.2011, “Per disa ndryshime ne udhezimin Nr.3 date 15.02.2001 te Keshillit te Ministrave, “Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit” te ndryshuar:

Mbikqyrja e punimeve kryhet nga persona fizike dhe juridike te paisur me certifikate personale perkatese. Mbikqyrja e punimeve per objekte qe ndertohen me financim publik, emerohet nga investitori pas zgjedhjes me prokurim ne perputheje me ligjin nr.9643, date 20.11.2006, “Per prokurimin publik”, te ndryshuar.

Koha e mbikqyrjes se punimeve lidhet me kohen e zgjatjes se punimeve dhe fillon, nga data e lidhjes se kontartes me firmen zbatuese.

### 1. Objektivi kryesor i Mbikqyrësit

1.1 Mbikqyrësi i punimeve të zbatimit të objektit ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjeke mbarevajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor

te percaktuar per kryerjen e punimeve.

## **2. Detyrat, pergjegjesite dhe te drejttat e Mbikqyresit**

2.1 Ne realizimin e objektive per zbatimin e punimeve te projektit, Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet:

- Te mbikqyre kontraten e zbatimit te punimeve ne emer te Autoritetit Kontraktor dhe te kryeje te gjitha detyrimet sipas kontrates se nenshkruar dhe legjislacionit ne fuqi.
- Te njihet ne detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike te objektit, te hartoje programin e kontrollit per zbatimin e projektit dhe cilesise se punimeve, si dhe zbatimit te VNM ne baze te standarteve te percaktuara me ligj (sipas Ligjit Nr. 8402, dt. 10.09.1998, VKM Nr. 3, dt 15.02.2011, VKM Nr. 1, dt.22.02.2005, VKM Nr. 2, date 13.05.2005).
- Te paraqese prane Autoritetit Kontraktor stafin e tij mbikqyres, siç eshte percaktuar ne kerkesat e stafit kryesor.

2.2 Mbikqyresi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Kontraktor, duke percaktuar detyrimet e ndersjellta, kushtet e punes, shperblimin, etj.

2.3 Mbikqyresi ve ne dijeni Autoritetin Kontraktor per nenkontraktoret e mundshem qe zgjedh Sipermaresi (Zbatuesi i Punimeve) ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve.

2.4 Mbikqyresi ne fillim te punimeve ne objekt, merr kontakt me organet qeverisese, ne juridiksionin e te cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesorë pergjegjes per ndertimin e ketij objekti, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi (Neni 9, ligji Nr.8402, dt.10.09.1998).

## **3. Detyrat e mbikqyresit**

3.1 Mbikqyresi ka per detyre:

- Te kontrolloje vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit me të dhënat e mëposhtme:
  - Emertimi i objektit:
  - Investitori:
  - Sipermarresi dhe drejtuesi teknik:
  - Mbikqyresi:
  - Afati i ndertimit te objektit:
  - Vlera e objektit:

3.2 Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet :

- Te marre masat e duhura per sigurine e objektit duke kontrolluar vendosjen ne objekt te tabelave perkatese sinjalizuese, treguese e te sigurise, shiritave, fenereve, etj.

## Dokumentat Standarde të Tenderit

- Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzohet pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin, si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku të përfshihen:

- Staf i Sipërmarresit
- Makinerite që do përdoren.

- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makinerite të Sipërmarresit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së zbatimit.

- Të kontrollojë zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet, nëse ka, dhe t'i propozojë Autoritetit Kontraktor zgjidhjet konkrete.

- Të ndjejë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve.

- Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme piktimin e objektit dhe çdo material që vendoset në vepe, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.

- Për çdo punim të maskuar të bëjë (fotografimin ose regjistrimin e tij dhe të mbajë procesverbal të firmosur prej tij dhe sipërmarresit.

- Të kontrollojë çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe të japë miratimin për vendosjen e tyre në objekt.

- Korrespondenca ndërmjet palëve bëhet gjithnjë në mënyrë zyrtare, me shkrim.

### **4. Përgjegjësitë e Mbikqyresit**

4.1 Në fillim të punimeve Mbikqyresi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtem:

- Projektin e firmosur nga investitori me specifikimet teknike.

- Dokumentacionin për realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike.

- Saktësinë e vertetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve.

- Për realizimin me korrektesë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarresit dhe Autoritetit Kontraktor, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit.

- Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyresit. Sipërmarresi duhet të njoftojë Mbikqyresin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij.

## 5. Te drejtat e Mbikqyresit

### 5.1 Mbikqyresi ka te drejte:

- Te mos pranoje drejtues teknik, manovrator, punetor, etj, nqs keta nuk plotesojne kushtet per te kryer detyren e caktuar.
- Te pezulloje punimet kur sheh se ne objekt nuk jane marre masat e duhura per te siguruar punimet dhe trafikun.
- Te mos lejoje vendosjen ne veper te materialeve qe nuk plotesojne kushtet e cilesise.
- Te kerkoje per te gjitha makinerite qe punojne ne veper dokumentacionet teknike per te siguruar nje ecuri punimesh te sigurta dhe cilesore.
- Per çdo ndryshim te mundshem ne objekt, Mbikqyresi i punimeve ve ne dijeni Autoritetin Kontraktor.

### 5.2 Ky dokumentacion duhet te permbaje:

- Proçes-verbalin per fillimin e punimeve
- Projekt organizimin e punimeve
- Projektin teknik te zbatimit
- Grafikon e punimeve
- Specifikimet teknike
- Dokumentacionin fotografik apo video regjistruesi per punimet e padukshme
- Proçes-verbalet e çdo punimi te maskuar te firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyresi te shoqeruar me fotografi
- Çertifikatat e cilesise se materialeve
- Deklaraten teknike te Sipermarresit te firmosur nga Sipermarresi dhe drejtuesi teknik
- Njoftimin e sipermarresit per perfundimin e punimeve
- Proçes-verbalin e perfundimit te punimeve te firmosur nga Sipermarresi dhe Mbikqyresi.
- Relacionin perfundimtar te Mbikqyresit

### 5.3 Nje kopje e te gjithë dokumentacionit dorezohet prane grupit te kolaudimit.

## Shtojca 12

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Dokumentat Standarde të Tenderit

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

Dokumentat Standarde të Tenderit

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

**KUSHTET E PËRGJITHSHME**  
**Shërbimet –Kërkesë për propozim**

## **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

## **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar ne ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas

dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6 Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit

Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.

- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

### **Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

